



V E N D I M

Nr. 56, datë 06.06.2017

“PËR EMËRTIMIN E SHKOLLËS 9 - VJEÇARE ME EMRIN “BETIM MUÇO”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b) dhe pika 1/1.7, shkronja (b), nenit 54, shkronja (ll) dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), si dhe në vijim të kërkesës pranë Bashkisë së Tiranës së Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, parashtruar me shkresën nr.prot. 1647, datë 23.05.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I :

- 1.** Shkollës 9 - vjeçare e ndodhur në Njësinë Administrative Nr. 6 në Kombinat, Tiranë, t’i jepet emri “Betim Muço”.
- 2.** Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 3.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI